

SHTOJCE NR. 1

Tiranë, më: 28.01.2020

**“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt:
“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli”
Elbasan”**

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”, me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 81,401,951 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe REF-46137-12-13-2019, hartoi këtë shtojcë për ndryshime të dokumenteve të tenderit, si më poshtë:

Në dokumentet e tenderit, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”:

Tek pika 3.3, Kapaciteti teknik, nënpika 4:

ISHTE:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019.

BËHET:

4. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 20 (njëzetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Qershor 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2019.

Në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4

(katër) vite, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”, me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 81,401,951 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe REF-46137-12-13-2019, afati kohor për dorëzimin e ofertave, shtyhet për në datën 04.02.2020 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.